

Nr. 1474 Prot., Datë 14.12.2016

Nr. 3334/2 Prot., Datë 14.12.2016

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
MIDIS
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DHE
UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale i përfaqësuar nga Komisioneri, z. Besnik DERVISHI (më poshtë “KDIMDP”)

dhe

Universiteti i Tiranës, i përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Mynyr KONI (më poshtë “UT”),

Duke vlerësuar kontributin e deritanishëm në zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta; të angazhuar për garantimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në veçanti, në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale të studentëve, stafit akademik dhe personelit administrativ të Universitetit të Tiranës; me dëshirën e mirë për të konsoliduar bashkëpunimin tonë në drejtime konkrete; për të siguruar të ardhmen e një brezi të ri të mbrojtur dhe të mirëinformuar për të drejtat e tyre; dhe për të nxitur forcimin e këtij sektori si një model për shoqërinë në garantimin dhe zbatimin e të drejtave themelore të njeriut; palët bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë “Marrëveshja”).

Neni 1
Baza ligjore

Kjo **Marrëveshje** bazohet në të drejtat dhe detyrimet e palëve të përcaktuara në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, në ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar dhe në ligjin nr. 80 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2 Qëllimi

Kjo **Marrëveshje** ka për qëllim bashkëpunimin e ndërsjelltë midis **KDIMDP** dhe **UT** në:

1. zbatimin e standardeve më të larta në respektimin dhe ruajtjen e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe në respektimin e të drejtës për informim për dokumentat zyrtare;
2. zbatimin e procedurave më të mira për shkëmbimin e ndërsjelltë të informacionit;
3. forcimin e kulturës në institucionet e arsimit të lartë për dije të thelluara në fushat e të drejtës për informim dhe atë të privatësisë.

Neni 3 Sfera e bashkëpunimit

KDIMDP dhe **UT** angazhohen të bashkëpunojnë në:

1. aplikimin për projekte të përbashkëta në fushën e të drejtës për informim dhe asaj për mbrojtjen e të dhënave personale dhe zbatimin e tyre, me objekt kërkimin shkencor dhe kontributin për përmirësimin e legjislacionit në këto sfera, sipas praktikës më të mirë ndërkombëtare;
2. organizimin e një shkolle dimërore të të drejtës për informim dhe të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, e cila do të aftësojë studentët në këto fusha;
3. pjesëmarrjen në aktivitete trajnimi të zhvilluara nga secila palë, sidomos, me përfshirjen aktive të studentëve;
4. organizimin e konferencave, takimeve, workshop-eve ose tryezave të rumbullakëta për të nxitur ndërgjegjësimin e studentëve, stafit akademik dhe personelit administrativ, me qëllimin për të krijuar një kulturë gjithëpërfshirëse për njohjen dhe ushtrimin e të drejtave të tyre;
5. krijimin e grupeve të vullnetarëve, kryesisht me studentë, për të promovuar këto fusha nëpërmjet ndërgjegjësimit në terren;
6. ndërmarrjen e çdo iniciative me interes të ndërsjelltë, si dhe me përfshirjen e aktorëve të shoqërisë civile, me fokus transparencën, balancën dhe burimin e informacionit;
7. trajnime periodike me stafin akademik dhe personelin administrativ të **UT** në lidhje me detyrimet që burojnë nga ligjet "Për të drejtën e informimit" dhe "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Neni 4 Të drejta dhe detyrimet e palëve

Në përmbushje të kësaj **Marrëveshje**, **KDIMDP** dhe **UT** kanë këto të drejta dhe detyrime:

1. të marrin pjesë në takime të grupeve të punës të ngritura nga secila palë për çështje që janë objekt i kësaj **Marrëveshje**;
2. të organizojnë shkëmbime profesionale në funksion të veprimtarisë së institucioneve që palët përfaqësojnë;
3. të përpilojnë raporte pas përfundimit të çdo aktiviteti të përbashkët;
4. të marrin pjesë në aktivitete kombëtare apo ndërkombëtare, që i shërbejnë dhe janë në funksion të përmbushjes së kësaj **Marrëveshje**;

5. të bashkëpunojnë për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale;
6. të bashkëpunojnë në hartimin e propozimeve në kuadër të përmirësimeve ligjore dhe nënligjore në fushat e mbrojtjes së të dhënave dhe të drejtës për informim.

Neni 5

Koordinimi ndërmjet palëve

1. Në zbatim të kësaj **Marrëveshje**, **KDIMDP** dhe **UT** do të caktojnë nga një person kontakti.
2. Personat e kontaktit do mbajnë takime mes tyre, në varësi të fluksit të shkëmbimit të informacionit për zbatimin e kësaj **Marrëveshje**.
3. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore, duke mos përjashtuar edhe format më të shpejta të komunikimit.
4. Palët do të njoftojnë reciprokisht në rast se ndryshohet personi i kontaktit.

Neni 6

Përmirësimet, Ndryshimet, Shtesat

1. Palët mund të bëjnë përmirësime, ndryshime dhe/apo shtesa në këtë **Marrëveshje**, bazuar në pëlqimin e ndërsjelltë të tyre.
2. Çdo përmirësim, ndryshim dhe/apo shtesë do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e **KDIMDP** dhe **UT**, apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të tyre.
3. Pjesë e kësaj **Marrëveshje** është edhe Aneksi "**Për themelimin dhe funksionimin e Shkollës Dimërore "Informim dhe Privatësi"**.

Neni 7

Mirëbesimi

1. **KDIMDP** dhe **UT** do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjelltë.
2. Palët duhet të mbajnë në mirëbesim të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë **Marrëveshje**.

Neni 8

Afati i marrëveshjes

1. Kjo **Marrëveshje** do të lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
2. **Marrëveshja** mund të përfundojë nga secila **Palë** nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim **Palës** tjetër, të paktën një muaj përpara.
3. Në rast të përfundimit të kësaj **Marrëveshje**, palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo **Marrëveshje**, përsa i përket informacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit të saj.

Neni 9
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo **Marrëveshje** hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. **Marrëveshja** është hartuar në Tiranë, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në **Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale** dhe dy të tjera në **Rektoratin e Universitetit të Tiranës**.
3. **Marrëveshja e Bashkëpunimit** e nënshkruar në datë 31.01.2013 ndërmjet **Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale** dhe **Rektoratit të Universitetit të Tiranës** shfuqizohet.

Për

**Komisionerin për të Drejtën e Informimit
dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

Z. Besnik DERVISHI



Për

Universitetin e Tiranës

Prof. Dr. Mynyr KONI

REKTORI



ANEKS

Për themelimin dhe funksionimin e Shkollës Dimërore "Informim dhe Privatësi"

1. Objekti i këtij Aneksi është organizimi i Shkollës Dimërore "Informim dhe Privatësi", në përputhje me nenin 3 pika 2 të të Marrëveshjes së lidhur midis Zyrës së Komisionerit dhe Universitetit të Tiranës.
2. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) dhe Universiteti i Tiranës (UT) marrin përsipër bashkërisht organizimin e kësaj Shkollë, për zhvillimin e trajnimeve/kurseve për aftësimin e studentëve në marrjen e njohurive mbi të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, Palët emërojnë përfaqësuesit e tyre që do të ngarkohen me mbarëvajtjen administrative dhe akademike, para dhe gjatë periudhës së funksionimit të Shkollës.
3. Ky kurs do të zgjasë për 5 ditë dhe do të zhvillohet në muajin Janar.
4. Të drejtën për të marrë pjesë në Shkollë do ta kenë studentët e vitit të tretë të programeve të studimeve bachelor dhe studentët e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë sipas secilit fakultet.
5. Në këtë Shkollë kanë të drejtën të regjistrohen edhe personeli akademik dhe ai mbështetës në UT dhe të tjerë, që mund të kenë interes në këto fusha.
6. Programin mësimor do të realizohet nga stafi i KDIMDP, dhe në bashkëpunim me personelin akademik të UT.
7. Studentët do të marrin njohuri mbi legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe zbatimin e tij, raste studimore nga praktika kombëtare dhe ndërkombëtare në këto fusha.
8. Në fund të kursit studentët/pjesëmarrësit do të pajisen me certifikatë. Certifikatat do të nënshkruhen nga Komisioneri dhe Rektori dhe në përmbajtje do të kenë 2(dy) kredite.
9. Të paktën 1 (një) muaj përpara fillimit, në mjediset e Zyrës së Komisionerit dhe në ato të Rektoratit, si edhe në faqet e tyre zyrtare në internet do të publikohet fillimi i Shkollës Dimërore dhe formulari i aplikimit.
10. Përzgjedhja e pjesëmarrësve do të bëhet nga një komision i posaçëm i ngritur për këtë qëllim me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga të dy institucionet.
11. Tematikat e trajtimit do të zhvillohen sipas një planit përpara fillimit të kursit dimëror. Në plani e zhvillimit do të përcaktohen datat dhe oraret e zhvillimit të kursit, trajnuesit, literatura dhe materialet e nevojshme, salla ku do të zhvillohet kursi, si dhe modalitete të tjera.
12. Palët marrin përsipër të gjejnë fondet e nevojshme për zhvillimin e kursit sipas burimeve të njohura nga legjislacioni në fuqi.
13. Ky Aneks nënshkruhet dhe zbatohet së bashku me Marrëveshjen e Bashkëpunimit.
14. Të gjitha interpretimet dhe çështjet që do të lindin gjatë zbatimit të tij do të trajtohen në frymën e realizimit të objektivave dhe qëllimit të Marrëveshjes.

**Komisioneri për të Drejtën e Informimit
dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**



Universiteti i Tiranës



**REKTORI
Mynyr KONI**